

Sipas nenit 46 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës Administratori kryen funksionet si më poshtë:

- Është përgjegjës për veprimtarinë e përgjithshme administrative dhe financiare të UST-së, për vendosjen dhe drejtimin e politikave dhe procedurave në mënyrë që të sigurojë në kohë dhe në mënyrë profesionale përmbushjen e detyrave, në formulimin dhe zbatimin e politikave të UST-së;
- Është drejtuesi administrativ i këtij institucioni, zbaton vendimet e marra nga Bordi i Administrimit dhe raporton te Bordi i Administrimit, që është eprori direkt i tij. Planifikon, organizon dhe drejton veprimtarinë e UST-së, nëpërmjet drejtimit administrativ;
- Zbaton të gjitha vendimet e Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
- I paraqet për miratim Bordit të Administrimit, rregulloren financiare, strukturën dhe kriteret e emërimit të punonjësve administrativë;
- Emëron dhe shkarkon personelin administrativ të UST-së, në përputhje me kriteret, organikën e miratuar dhe legjislacionin në fuqi;
- Emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore pas miratimit të Bordit të Administrimit;
- Kontrollon zbatimin e rregullave të etikës nga personeli administrativ dhe merr masat e duhura disiplinore ndaj shkeljeve të konstatuara;
- Menaxhon personelin administrativ të UST-së, në mënyrë të tillë që formulimi dhe zbatimi i politikës së UST-së të jetë i mirëkoordinuar dhe veprimtaria e stafit të përmbushet si duhet dhe në kohën e përcaktuar;
- Miraton planet vjetore të punës së njësive në varësi të tij strukturore e funksionale dhe kontrollon realizimin e tyre;
- Përfaqëson UST-në përpara gjykatave, institucioneve shtetërore, apo subjekteve të tjera për çështje administrative dhe financiare në kompetencë të tij; nënshkruan dokumentet e hartuara me karakter administrativ dhe financiar, që dalin në emër të UST-së;
- Nxjerr urdhra dhe akte të tjera në funksion të drejtimit të veprimtarisë administrative e financiare brenda institucionit;
- Ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e titullarit të autoritetit kontraktor – Universiteti i Sporteve të Tiranës – bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike;
- Koordinon punën për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 3-vjeçar për Universitetin e Sporteve të Tiranës. Harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
- Propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
- Propozon në Bordin e Administrimit të UST-së ndryshimin e destinacionit të fondeve nga një njësi shpenzuese në një tjetër në rast aplikimi;
- Miraton detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese në rast se aplikohet;

- Shqyrton kërkesat dhe miraton rishpërndarjet brenda të njëjtit artikull buxhetor të shpenzimeve aktuale, pa tejkaluar limitet buxhetore të miratuara nga Bordi i Administrimit;
- Përgjigjet për mbajtjen e kontabilitetit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij;
- Raporton te Bordi i Administrimit për mbylljen e llogarive të mjeteve monetare dhe të buxhetit vjetor përmbledhës të UST-së;
- Përgatit dhe raporton te Bordi i Administrimit analizën vjetore përmbledhëse të UST-së;
- I paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;
- Administratori mund t'u delegojë një ose disa nga kompetencat e tij organeve varëse, sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurave Administrative në RSH-së;
- Siguron realizimin e kërkesave me karakter administrativ dhe financiar të Senatit Akademik dhe të Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- Nënshkruan kontratat e punës së personelit administrativ;
- Në bashkëpunim me strukturat akademike dhe administrative të Universitetit, harton dhe ndjek realizimin e një plani afatmesëm/afatgjatë me detyra të sakta e me afate kohore, për gjenerimin e të ardhurave alternative, duke synuar rritjen graduale të pavarësisë financiare, përmes rritjes së përqindjes së të ardhurave të UST-së në totalin e buxhetit të tij;
- Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen në Rregulloren e UST-së dhe në akte të tjera të institucionit.